

KALENDARI I PËRBASHKËT KULTUROR VJETOR

MIDIS

**MINISTRISË SË KULTURËS
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

DHE

**MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Tiranë, 2021

Referuar "Deklaratës së Përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës", nënshkruar në Prizren më datë 11 janar 2014, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës, bien dakord për përfshirjen e aktiviteteve të mëposhtme në Kalendarin e Përbashkët Vjetor për vitin 2022.

KREU I AKTIVITETE TË NATYRËS SË PËRGJITHSHME

Bashkërendimi për çështjen e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në organizatat kulturore ndërkombëtare.

KREU II MENAXHIMI KULTUROR

Të dyja vendet do të angazhohen të krijojnë kushtet dhe mundësitë për shqyrtimin dhe hartimin e një programi të përbashkët për Menaxhimin Kulturor dhe shkëmbimin e artistëve.

KREU III LIBRI, LEXIMI DHE BIBLIOTEKAT

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

Në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë gjatë vitit 2022, do të realizojë veprimtaritë si vijon:

- a. Konferencë Kombëtare e Bibliotekonomisë
- b. Konferencë shkencore dhe Ekspozitë për Branko Merxhanin, në kuadër të 40-Vjetorit të ndarjes nga jeta të Branko Merxhanit
- c. Konferencë shkencore dhe Ekspozitë për Pjetër Budin, në kuadër të 400-Vjetori të vdekjes së autorit
- d. Konferencë shkencore dhe Ekspozitë për Krist Malokin, në kuadër 50 vjetorit të ndarjes nga jeta të Krist Malokit

Palët do të organizojnë veprimtaritë sipas rendit dhe reciprokisht, secili institucion e organizon veprimtarinë në vendin ku mbahet veprimtaria, në Shqipëri – BKSh, në Kosovë - BKK. Programi i veprimtarisë propozohet nga një komitet i përbashkët bashkërendimi, i caktuar nga Drejtoritë e të dyja institucioneve dhe miratohen prej këtyre Drejtorive.

KREU IV FILMI

Qendra Kombëtare Kinematografike

1. Pjesëmarrje e përbashkët në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Berlin, ku Qendra Kinematografike e Kosovës bashkë me Qendrën Kombëtare e Kinematografisë kanë një stendë të përbashkët në Marketin e Filmit në Berlin ku promovohet kinematografia e të dyja vendeve
2. Pjesëmarrje e përbashkët në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Cannes ku Qendra Kinematografike e Kosovës bashkë me Qendrën Kombëtare e Kinematografisë kanë një stendë të përbashkët në Marche du Film, Cannes ku promovohet kinematografia e të dyja vendeve
3. Bashkëpunimi me Festalet e tjera ndërkombëtare të Filmit të organizuara në Shqipëri dhe të financuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë

KREU V TEATRI , ANSAMBLI DHE BALETI

1. **Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor**
 - a. Realizimi i shfaqjes së titulluar "Carmina Burana" të kompozitorit Carl Orff në Prishtinë dhe Tiranë
 - b. Realizimi i një shfaqje baleti të titulluar "Monger" në Teatrin Kombëtar të Kosovës
 - c. Realizimi i një shfaqje të përbashkët në gjinin e këngës popullore midis Ansambli Popullor dhe Ansambli të Këngëve dhe Valleve "Shota", të titulluar "Gjerdani i Artë" nga artistet Fitnete Rexha & Nexhmije Pagarusha
2. **Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli"**
 - a. Realizimi i festivalit të regjisorëve dhe dramaturgëve të rinj
 - b. Realizimi i një shfaqje të titulluar "Hevay stone"- një bashkëproduksion i TKEKS, Teatrit ODA dhe "Qendra për fëmijët dhe të rinjtë", me fokus emigrimin e të rinjve
 - c. Pjesëmarrja e TKEKS në festivalin "Femart" në Qershor 2022
 - d. Pjesëmarrja e Artpolis në festivalin që do të organizojë TKEKS në Prill 2022, të titulluar "Tirana contemporary theater fair"
3. **Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë**
 - a. Konkurse të ndryshme për fëmijë, shfaqje për fëmijët e diasporës shqiptare.

